



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:250596

Datë: 28.10.2022

Numri i dokumentit: 03582722

PKR.nr.185/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Krimeve të Rënda, me kryetarin e trupit gjykues Murat Hulaj, me anëtarët e trupit gjykues, gjyqtarët profesionist Arben Mustafaj dhe Leon Përlaskaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Teuta Spahija, në çështjen penale kundër të akuzuarit I. M.nga fsh. I., K. Deçan, për shkak të veprës penale, **“Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm”**, nga neni 367 par.1, të KPRK-së, si dhe për shkak të veprës penale, **“Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve”**, nga neni 366 par.1, të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti për krime të rënda, PP/I. Nr.229/2021 të datës 18.11.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor gjyqësor me datë 11.10.2022, në prezencë të Prokurores së shtetit Valbona Disha Haxhosaj, të akuzuarit I. M.si dhe mbrojtësi i tij, av. Asdren Mekaj, i caktuar sipas detyre zyrtare, te njëjtën dite mori dhe publikisht shpalli me dt.**11.10.2022**, ndërsa me dt.28.10.2022, nxori këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

I. M., i biri i I. dhe nënës G., e vajzërisë B., i lindur më datë lindja në Deçan, ndërsa tani me vendbanim në rr.”N. B.”, nr.7 në fsh. I. K. Deçan, ku edhe tani banon, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., posedues i nr. të tel. 048/ ..-..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i njëjti gjendet në paraburgim për një çështje tjetër.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak së:

I. Në muajin Maj të vitit 2021, në kohë të pacaktuar ne vendin e quajtur ‘B. e R. ’ K-Deçan, ka përdorë armën e zjarrit në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët dhe atë armën automatike A.-..., në atë mënyrë që ditën kritike gjersa i pandehuri ka qenë në Sektorin e Hetimeve në Deçan, për një rast të vjedhjes së rëndë, policia e kanë kontrolluar telefonin e tij dhe e kane vërejtur disa foto dhe video–incizime ku i pandehuri I. M.shihet duke shtënë me armë zjarri në vendin e lartcekur.

Me çka ka kryer veprën penale **“Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm ”**nga neni 367 par. 1 të KPRK-së.

II. Më parë gjerë në muajin Maj të vitit 2021 në ‘B. e R. ‘, K-Deçan, i pandehuri në kundërshtim me nenin 5 par.1 të Ligjit Për Armë(Ligji Nr.05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll dhe atë: një armë automatike A.-., në atë mënyrë që ditën kritike gjersa i pandehuri ka qenë në Sektorin e Hetimeve në Deçan, për një rast të vjedhjes së rëndë, policia e kanë kontrolluar telefonin e tij dhe kanë vërejtur disa foto dhe video-incizime ku i pandehuri I. M.shihet me armë në dorë në vendin e lartcekur.

Me çka ka kryer veprën penale **“ Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”**, nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Andaj në aplikim të nenit 4, 7, 8 par.1, 21, 38, 39, 40 par.1 pika 1.2, 42, 69, 70, 76, nga neni 367 par. 1 dhe neni 366 par.1, të KPRK-së, neni 364, 366, dhe 453 të KPPRK-së, të akuzuarit i:

P ë r c a k t o n

Për veprën penale **“Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”**, nga neni 367 par. 1 të KPRK-së i përcakton dënim 1 (një) vjet burgim.

Për veprën penale **“ Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”**, nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, përcakton dënim 1 (një) vjet burgim.

Pas unifikimit të dënimeve konform nenit 76 par.1 dhe par.2 pika 2.2 e lidhur me nenet 46, 47,48, 49, të KPRK-së, gjykata të akuzuarin I. M.e:

G J Y K O N:

- I.Me dënim unik me burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) vjet e 6 (gjashtë) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej dy (2) vitesh, nuk kryen veprën tjetër penale.
- II.Dënimimi me kusht nga dispozitivi I të këtij aktgjykimi do të revokohet nëse i pandehuri kryen veprën tjetër penale.
- III.Obligohet i akuzuari që në emër të paushallin gjyqësor të paguaj shumë prej 30 (tridhjetë) euro, si dhe shumën prej 50 (pesëdhjete) euro ne emër të kompensimin të viktimave te krimet.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda, ka ngritur aktakuzën nën shenjë PP/I. Nr.229/2021 të datës 18.11.2021, kundër të I. M.nga fsh. I., rr.”N. B.”,nr., K. Deçan, për shkak të veprës penale **“Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm”** nga neni 367 par.1 të KPRK-së, si dhe për shkak të veprës penale, **“Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve”**, nga neni 366 par.1, të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar, me datë 13.12.2021. Gjatë asaj seancë, në prezencën e Prokurores së Shtetit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av. Asdren Mekaj, i akuzuari

pas njoftimit me drejtat dhe detyrimet e tij, është deklaruar **i pafajshëm** për veprat penale për të cilat ngarkohet.

Pas kësaj, gjykata konform nenit 245 par. 6 të KPPRK-së, të njëjtin ka udhëzuar që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh ka të drejtë që ta paraqes kundërshtimin e provave, kërkesën për hudhje të aktakuzës, si dhe propozime tjera.

I akuzuari edhe pse ka qene i njoftuar, nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e tij ligjore për parashtrimin e kundërshtimit të provave ose kërkesës për hedhje të aktakuzës, ashtu që gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor gjyqësor me datën 11.10.2022, në të cilën kanë qenë prezentë Prokurorja e Shtetit Valbona Disha Haxhosaj, i akuzuari I. M. dhe mbrojtësi i tij Av. Asdren Mekaj, pas leximit të aktakuzës nën shenjen PP/I Nr. 229/2021 të datës 18.11.2021, të akuzuarit konform nenit 325 të KPPRK-së, i është dhënë mundësia që prapë të deklarohet për fajësinë apo pafajësinë e tij.

Në këtë rast gjykata pas udhëzimit për rëndësinë dhe pasojat, kushtet dhe privilegjet e pranimit të fajësisë, konsultimet të mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe i akuzuari I. M., ka deklaruar se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije **e pranon fajësinë**, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës pa asnjë ndryshim, i vjen keq për veprimin e bërë.

Në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit I.M., gjykata ka marrë mendimin e palëve tjera në procedure.

Prokurorja e shtetit, në lidhje me pranimin e fajësisë, nga ana e të pandehurit, I.M., ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, meqenëse ky pranim korrospodon edhe me provat në bazë të cilave është ngritë aktakuza, andaj i propozoj gjykatës që ketë pranim të fajësisë ta **APROVON**.*

Mbrojtësi i të pandehurit av. Asdren Mekaj, në lidhje me pranimin e fajësisë ka deklaruar se: *lutemi që ky pranim i fajësisë të pranohet meqenëse i njëjtit është bere në mënyrë vullnetare pas konsultimeve të mjaftueshme me mua si mbrojtës dhe është në përputhje me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.*

Në vijim gjykata duke shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit I. M. se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarit, pasi që ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, konsultimet e mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pasi që ky pranim i fajësisë gjen mbështetje edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe po ashtu është bërë konform dispozitave përkatëse ligjore, nga neni 248 par. 1 nën par. 1.1 e gjerë në 1.4 e lidhur me nenin 326 të KPPRK-së.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata me Aktvendim procedural e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ngasë pranimi i fajësisë gjen mbështetje edhe në provat vijuese: *raporti i oficerit J. J. me nr. te rastit 2021-/-... te dt.27.05.2021, foto albumi se bashku me CD, informacionet lidhur me te kaluarën e dyshuar te pandehurit, si dhe shkresat e tjera te lëndës, dhe mbi këtë është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë, se i akuzuari ka kryer veprat penale të cilat i vihen në barrë, si dhe faktin se janë plotësuar kushtet nga neni 248 par. 1, nën par. 1.1, e gjerë në 1.4, të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të akuzuarit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 326 par. 4 të KPPRK-së ka vazhduar me fjalën përfundimtare dhe shqiptimin e dënimit.*

Prokurorja e Shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: *meqenëse i akuzuari e pranon fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet, në tërësi mbes pranë akuzës, përshkrimin faktik dhe juridik të veprave penale dhe i propozoj gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtor, të dënoj sipas ligjit si dhe ta obligon në kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale. Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim, i propozoj gjykatës që si rrethane lehtësuese ta vlerësoi pranimin e fajësisë di dhe mosdenushmerinë e tij të mëparshme të akuzuarit kurse si rrethana renduese në rastin konkret nuk ka gjetur.*

Mbrojtësi e të akuzuarit av. Asdren Mekaj ne fjalën përfundimtare ka deklaruar: *meqenëse i mbrojturi im ka pranuar fajësinë, lusim gjykatën që më rastin e marrjes së vendimit mbi dënim të ketë parsyshë rrethanat lehtësuese, pranimin e fajësisë në mënyrë vullnetare, gjendja e dobët ekonomike, faktin se asnjëherë me pare nuk ka qene i dënuar për vepra e tille penale e gjithashtu sjelljen e tij shume korrekte pranë organeve të drejtësisë, po ashtu lusim gjykatën që edhe me një dënim të kushtëzuar ta arrin qëllimin e dënimit.*

I akuzuari I. M. ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se: *me vjen keq që ka ndodhur, jam penduar shume, kam qene i ri në momentin e kryerjes kam pas 19 vjetë, i premtoj gjykatës i propozoj gjykatës që nuk do të përsërisë veprime të tilla në të ardhmen, i kërkoj gjykatës që të me shqiptoj një dënim sa më të butë.*

Andaj me faktet e ofruara ne shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të akuzuarit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, “ Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”, nga neni 367 par.1, të KPRK-së, si dhe për shkak të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366 par.1, të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë, gjykata ka gjetur se te i akuzuari ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale, nuk janë paraqit rrethana, të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është vërtetuar se është fajtor dhe penalisht përgjegjës.

Kryetari i trupit gjykues në aplikim të neneve 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe renduese të përcaktuara e të përmendura nga ana e palëve në procedurë gjatë seancës të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se i akuzuari ka bërë pranimin e fajësisë në mënyrë të vullnetshme, në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, pendimin e tij duke shprehur keqardhje për rastin e ndodhur, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të këtilla, do të jetë më i kujdesshëm, është i pa punë, është i gjendjes së dobët ekonomike. Ndërsa si rrethana renduese gjykata gjeti se i njëjti edhe me pare ka qene i dënuar për veprën penale sipas aktgjykimit P.nr.209/21 të datës 13.01.2022.

Gjykata në raport me veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1, të KPRK-së, ka aplikuar dispozitat e nenit 72 par.1, pika 1.5, qe i referohet kufijve të zbutjes se dënimit, ku sipas pikës 1.5 të këtij neni thuhet nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej një (1) viti, dënimi mund të zbutet deri në tre (3) muaj burgim. Ne rastin konkret për veprën penale nga neni 367 par.1, të KRRK-ës, për këtë veprë penale është

e përcaktuar minimumi ligjor 1(një) vit dhe me maksimumi ligjor prej tetë vite, ashtu qe gjykata duke pasur për bazë rrethanat nga neni 69 par.1,2,3, pika 3.5, 3.6 dhe 3.7 dhe nenit 70 par.3, pikat, 3.9, 3.10, 3.11,të KPRK-së, Pranimin e fajësisë, sjelljen para gjykate, pendimin dhe keqardhjen, dhe premtimin e tije, se në të ardhmen nuk do të përsëritë veprime të tilla.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KRPK-së.

Vendimi mbi shqiptimin e dënimit me kusht u mor në përputhje me nenin 48 par.1 ,2 e lidhur me nenin 49 par.2 par.4, të KPK-ës, ku në dispozitën par.2 te nenit 49, qe i referohet kushteve mbi shqiptimit e dënimit me kusht saktësohet ne nenin 2, se dënimi me kusht mund t'i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në dhjetë (10) vjet, nëse zbatohen dispozitat e zbutjes së dënimit. Përderisa ne par. 4 thuhet se me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht, gjykata merr posaçërisht parasysh qëllimin e dënimit me kusht, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra penale.

Vendimi mbi unifikimin e dënimit u mor konform dispozitës ligjore të nenit 76 par. 1 dhe 2 nën par. 2.2 të KPRK-së.

Vendimi për mundësin e revokimit të dënimit me kusht gjykata do ta merre në përputhje me nenin 50 par.1,2,3, dhe 4, të KPRK-ës.

Vendimi për paguarjen e shpenzimeve procedurale, u morr konform nenit 450 par. 1, par.2 nën pika 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi për taksat e kompensimit të viktimave të krimit, u morr në bazë të qarkores për zbatimin e ligjit NR.05/L-36.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.185/21 dt. 28.10.2022

Bashkëpunëtorja Profesionale
Teuta Spahija

Kryetari i trupit gjykues,
Dr.sc.Murat Hulaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.